

GJYKATA E QARKUT NË PEJË

P.Nr. 68/12

Data: 04 Korrik 2012

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË PEJË, në trupin gjykues të përberë nga Gjyqtari i EULEX-it Ingo Risch si Kryetar i Trupit Gjykues, Gjyqtari i EULEX-it Dariusz Sielicki dhe Gjyqtari Kosovar Gëzim Pozhegu si anëtarë të trupit gjykues, të ndihmuar nga Procesmbajtësja Eriona Brading, në rastin penal kundër,

NV-t, i babait R dhe nënës Z, mbiemri i vajzërisë B, i lindur me ***** në fshatin *****i ***** , banon në vendin e njëjtë, punëtor me profesion, e ka përfunduar shkollën e mesme, Shqiptar, qytetar i Kosovës, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike.

I akuzuar me Aktakuzën e Zyrës së Prokurorisë së Qarkut në Pejë PP.nr. 429/11, i datës 17 Janar 2012, për veprën penale të *Vrasjes së Rëndë* në kundërshtim me nenin 147, pika 4 e KPK-së, vepra penale e *Lëndimit të Rëndë Trupor* në kundërshtim me Nenin 154, paragrafi 1 pika 3 e KPK-së dhe vepra penale e *Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve* sipas nenit 328 paragrafi 2 i KPK-së, e ndryshuar gjatë seancës së datës 04 Korrik 2012, me veprën penale të *Vrasjes së Rëndë* në kundërshtim me nenin 147, pika 4 e KPK-së dhe vepra penale e *mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve* sipas nenit 328 paragrafi 2 i KPK-së,

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimeve kryesore me datat 02, 03 dhe 04 Korrik 2012, në prani të Prokurorit Publik Peter Korneck, i akuzuari NV, avokatët e tij mbrojtës Gezim Kollcaku dhe Flamur Kelmendi, pala e dëmtuar DO (i pranishëm me datë 02 Korrik 2012),

pas këshillimit dhe votimit, trupi gjykues, me datë 04 korrik 2012, shpall publikisht, si në vijim;

AKTGJYKIM

I.

I akuzuari NV është gjetur,

FAJTOR

Për arsye se;

Me datë 20 Tetor 2011, rreth orës 12:00, në fshatin Dobrushë, Komuna e Istogut, afër shtëpisë së EV- nipi i të akuzuarit, me qëllim që ta privojë nga jeta viktimën MK, duke e qëlluar atë katër herë me armën e tij AK-47 dhe duke vepruar në atë mënyrë, i akuzuari ka rrezikuar jetët e DB dhe DO. Në ditën kritike, pasi që viktimë MK, i shoqëruar nga ana e DB dhe DO, ka shkuar në shtëpinë e fqinjëve Boshnjakë të të akuzuarit, ku i akuzuari NV ka ardhur pastaj me makinën e tij Volkswagen Golf 2, i akuzuari i është afruar tre personave, dhe pas një argumenti i cili është bërë në mes të tre personave në njërin anë dhe të akuzuarit në anën tjetër, i akuzuari ka shkuar tek makina e tij dhe ka marrë pushkën e tij automatike AK-47, është kthyer dhe në këtë moment DB ka gjuajtur dy të shtëna nga revolja e tij në drejtim të të akuzuarit, por e ka huqur. Në këtë moment, i akuzuari ka gjuajtur tek tre personat duke e qëlluar me këtë rast viktimën MK me një plumb në kokë e cila ka shkaktuar vdekjen e menjëhershme të MK. Me këtë gjuajte, i akuzuari po ashtu u ka shkaktuar plagë edhe palës së dëmtuar DB në që të dyja anët, në anën e majtë dhe të djathtë të pjesës së sipërme të krahut dhe i ka shkaktuar plagë në të dyja krahët, dhe lëndime palës tjetër të dëmtuar DO duke e qëlluar atë në thembrën e këmbës së tij të djathtë dhe i ka shkaktuar një plagë në këmbën e tij të djathtë dhe një thyerje në ashtin e thembrës së djathtë.

- me të cilën ka kryer veprën penale të *Vrasjes së Rëndë* sipas nenit 147 pika 4 e KPK-së,

II.

I akuzuari NV është gjetur,

FAJTOR

Për arsye se;

Që nga viti 2010 e deri me datë 20 Tetor 2011, i akuzuari ka qenë në posedim të një pushke automatike AK-47, me numër serik 71H5924 së bashku me dy karikatorë për armën e njëjtë dhe 36 plumba të kalibrit 7.62x39, pa pasur një autorizim të vlefshëm.

- Me të cilin ka kryer veprën penale të *mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve* sipas nenit 328, paragrafi 2 i KPK-së.

Andaj, sipas dispozitave të Neneve 6, 11, 15, 31, 32, 33, 34 pikat 1 dhe 2, 37, 64, paragrafi 1, 65 par 1, 71 par2, nën-par 1, 73 par 1, 99 par 1, Neni 147 pika 4, Neni 328 par 2 i KPK-së dhe Nenet 99 par 1,2 pikat 3,4,6 par 3, 102 par 1, 328 par 1, 385 par 1 dhe 2, 386 par 2, 387 par 1 dhe 2, 391 dhe 392 të KPPK-së, i akuzuari është ,

DËNUAR

- Për veprën penale nën Pikën I të këtij aktgjykimi me 15 (pesëmbëdhjetë) vite dhe 6 (gjashtë) muaj burgim,
- Për veprën penale nën Pikën II të këtij aktgjykimi me 1 (një) vit burgim,
- Sipas Nenit 71 par 1 dhe 2 si dhe nën-paragrafi 2 i KPK-së, dënimi unik është përcaktuar në 16 vite burgim.

Sipas Nenit 391, paragrafi 1, nën-paragrafi 5 i KPPK-së, koha e kaluar në paraburgim nga ana e të akuzuarit NV nga data 21 Tetor 2011 e deri më 04 Korrik 2012, do të llogaritet në dënim.

Sipas Nenit 54, paragrafi 1 dhe 3, nën-paragrafi 7 dhe Neni 60 i KPK-së, dënimi plotësues i konfiskimit të armës- një pushkë automatike e tipit AK-47, me numër serik 71H5924, së bashku me dy karikatorë për pushkën e njëjtë dhe 36 plumba të kalibrit 7.62x39, është caktuar kundër të akuzuarit të dënuar NV.

Sipas Nenit 99, paragrafi 2, pika 6 e KPPK-së, i akuzuari NV do të i paguajë shpenzimet e këtyre procedurave penale në shumë prej 400 (katërqind) Eurosh, duke llogaritur nga 100 (njëqind) €uro për secilën seancë dhe shuma e caktuar prej 100 (njëqind) €uro.

Pala e Dëmtuar mund të parashtroje padi për kompensim përmes gjykatave civile.

Arsyetimi

Sfondi Procedural

Me datë 18 Janar 2012, Zyra e EULEX-it e Prokurorisë së Qarkut në Pejë e ka parashtruar aktakuzën PP.nr. 429/11, me datë 17 Janar 2012 kundër NV për veprat penale të *Vrasjes së Rëndë* në kundërshtim me nenin 147, pika 4 e KPK-së, dy akuza për veprën penale të *Lëndimit të Rëndë Trupor* në kundërshtim me Nenin 154, paragrafi 1 pika 3 e KPK-së dhe vepra penale e *Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve sipas nenit 328 paragrafi 2 i KPK-së.*

Aktakuza është konfirmuar me datë 13 Shkurt 2012 nga gjyqtari për konfirmim i Gjykatës së Qarkut në Pejë, përmes aktvendimit KAQ.nr. 27/12.

Me datë 17 Prill 2012 Presidenti i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, duke vendosur sipas kërkesës së Kryetarit të Gjykatës së Qarkut të Pejës, ka vendosur për të marrë përsipër çështjen dhe ta caktojë atë në kompetencë të gjyqtarëve të EULEX-it për procedurë të mëtutjeshme.

Kompetencat dhe përbërja e trupit gjykues

Në përputhje me Nenin 23, paragrafi 1 i KPPK-së, Gjykatat e Qarkut do kenë kompetencë për të gjykuar në shkallë të parë veprat penale të dënueshme me të paktën pesë vjet burgim ose me burgim afatgjatë.

Në këtë rast, akuza kryesore kundër të pandehurit është vepra penale e *Vrasjes së Rëndë* në kundërshtim me nenin 147 pika 4 e KPK-së, e dënueshme me burgim prej së paku dhjetë (10) vitesh. Andaj, Gjykata e Qarkut në Pejë e ka kompetencë lëndore për të gjykuar rastin.

Vepra penale, sipas aktakuzës, është kryer në fshatin Dobrusha, Komuna e Istogut, e cila është brenda territorit të Qarkut të Pejës. Andaj, në përputhje me Nenin 27, paragrafi 1 i KPPK-së, gjykata e Qarkut të Pejës e ka juridiksionin territorial për ta gjykuar këtë rast.

Meqë ky rast i është ndarë në kompetencë gjyqtarëve të EULEX-it me vendimin e Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, me datë 17 Prill 2012, trupi gjykues është përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar Kosovar sipas Nenit 3.7 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

Asnjëra nga palët nuk ka pasur vërejtje në lidhje me përbërjen e trupit gjykues.

Seancat e Shqyrtimeve Kryesore

Shqyrtimi kryesor është mbajtur i hapur për publik me datë 02,03 dhe 04 Korrik 2012 në prani të Prokurorit të EULEX-it Peter Korneck, të akuzuarit NV dhe avokatët e tij mbrojtës Flamur Kelmendi dhe Gezim Kollcaku. Pala e dëmtuar DO ka qenë i pranishëm vetëm me datë 02 Korrik 2012, gjersa DB nuk ka qenë prezent edhe është ftuar në mënyrë të rregullt.

Në përputhje me Nenin 15 të KPPK-së, përkthyesit ndërkombëtarë kanë përkthyer në procedurat gjyqësore dhe të gjitha dokumentet gjyqësore të rëndësishme për gjykim janë përkthyer nga gjuha Angleze në Gjuhën Shqipe si dhe e kundërta.

Provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor

Gjatë rrjedhave të shqyrtimit kryesor, trupi gjykues ka dëgjuar dëshmitarët në vijim:

Dëshmitare *MV* ka dëshmuar para këtij trupi gjykues me datë 02 Korrik 2012.
Dëshmitar *AV* ka dëshmuar para këtij trupi gjykues me datë 02 Korrik 2012.
Dëshmitar *DO* ka dëshmuar para këtij trupi gjykues me datë 02 Korrik 2012.
Dëshmitari ekspert *NP* ka dëshmuar para këtij trupi gjykues me datë 03 Korrik 2012.
Dëshmitar *IT* ka dëshmuar para këtij trupi gjykues me datë 03 Korrik 2012.
Dëshmitar *SS* ka dëshmuar para këtij trupi gjykues me datë 03 Korrik 2012.
Dëshmitar *DK* ka dëshmuar para këtij trupi gjykues me datë 03 Korrik 2012.

Dëshmitar *GM* ka dëshmuar para këtij trupi gjykues me datë 03 Korrik 2012.

Provat e Dokumentuara

- Fleta e Kontrollit mjekësor për të pandehurin me numër 20816, me datë 21 Tetor 2011 nga Dr. PA.
- Certifikata për Konfiskim të Përkohshëm të Gjësendeve nr. 2011-DF-807 e datës 21 Tetor 2011,
- Certifikata për Bastisjen e Banesave dhe Personave e datës 20 Tetor 2011.
- Raporti i Zyrtarit Policor i përpiluar nga zyrtari ShT i datës 26 Tetor 2011,
- Raporti nga ekzaminimi i Vendit të Krimit i përpiluar nga zyrtarët SA dhe HB i datës 20 Tetor 2012.
- Foto-Albumi nga Vendi i Krimit që përmban 14 fotografi,
- Foto-Albumi që përmban 13 fotografi të armës së gjuetisë AK-47,
- Raporti nga ekzaminimi i Vendit të Krimit i përpiluar nga zyrtarja Valbona Kralani i datës 21 Tetor 2012,
- Foto Albumi nga Vendi i Krimit që përmban 45 fotografi, një skeç të vend krimit dhe legjendën ,
- Raporti i autopsisë MA11-245 i datës 21 Tetor 2011,
- Fotoalbumi i autopsisë (tre albume të ndryshme)
- Raporti nga ekzaminimi i makinës i datës 22 Tetor 2011,
- Raporti i ekzaminimit mbi ekzaminimin e Armëve të Zjarrit nr. 2011-2215/2011-2329 i datës 01 Nëntor 2011,
- Ndryshimi i Raportit të Kallëzimit Penal nr. 2011-DF-807 i datës 21/11/2011- Raporti i regjistrimit,
- Ekspertiza për DO e përpiluar nga Doktor BV i datës 05 Dhjetor 2011,
- Ekspertiza për DB e përpiluar nga doktor BV e datës 05 Dhjetor 2011

Gjetjet Faktike

Në mëngjesin e datës 20 Tetor 2011, i ndjeri MK, i shoqëruar nga DB dhe DO, ka shkuar në shtëpinë e E në fshatin Dobrushë, komuna e Istogut në mënyrë që të diskutonin ca qështje që kishin të bëjnë me tokën. MK dhe i akuzuari ishin pronar të parcelave që kufizoheshin. EV, nipi i të akuzuarit, ka qenë në Gjermani gjatë asaj kohe dhe gruaja e tij MV ka dhënë informata për ta informuar xhaxhain e saj dhe ajo e ka thirrur të akuzuarin dhe ka kërkuar nga ai që të vijë në shtëpi. Ai është informuar nga M se janë tre fqinjët e tokës që janë duke pritur për të dhe të tre personat e panjohur kanë thënë që ne e kemi okupuar tokën. I akuzuari i është përgjigjur M që ai do vijë nga Istogu dhe do jetë aty për 10 min. I akuzuari ka pritur një konflikt me këta persona dhe ka dashur që të jetë i përgatitur për një konflikt andaj e ka marrë armën e tij automatike AK-47, të paregjistruar, me makinën e tij dhe ai ka qenë i gatshëm që ta përdori armën e tij po që

nevoja. Arma e tij ka qenë e mbushur me së paku 4 plumba të municionit të duhur. Pasi që i akuzuari e ka parkuar makinën e tij afër shtëpisë së nipit të tij, i ndjeri MK, DB dhe DO i janë afruar të akuzuarit. Është zhvilluar një diskutim në lidhje me tokën e tyre dhe është shkallëzuar kur ata e kanë diskutuar çështjen e shitjes së tokës. I akuzuari ka qenë i interesuar për ta blerë një pjesë të pronës së ngjitur sepse mundësit e tija financiare ishin të kufizuara, gjersa i ndjeri MK ka theksuar se ai ishte i interesuar për një marrëveshje që përfshinte gjithë tokën e tij. I akuzuari ka ardhur në përfundim se ai nuk ishte në gjendje ta blinte gjithë tokën dhe ka vendosur që ta përdori armën e tij. Ai është nisur në makinë e tij të parkuar aty afër Volkswagen Golf 2 në të cilën ai e ka bartur Kallashnikovin e tij të mbushur në ulësen e bashkë udhëtarit. Ai e ka marrë pushkën e mbushur dhe e ka drejtuar kah tre vizitorët me qëllim që të gjuaj tek ata. Trupi gjykues nuk mundet që të përjashtojë faktin se edhe DB ka qenë i armatosur me një pistoletë, ai e ka nxjerrë revolen pasi që i akuzuari e ka drejtuar Kallashnikovin tek ata dhe po ashtu trupi gjykues nuk mund ta përjashtojë faktin se i cekuri DB ka gjuajtur dy herë me revolverin e tij në drejtim të akuzuarit para se i akuzuari të hapte zjarr nga arma e tij AK-47. Që të dyja këto gjuajte nga revolveri kanë dështuar dhe i akuzuari ka gjuajtur së paku katër plumba nga Kallashnikovi i tij në drejtim të tre vizitorëve me qëllim që ta mbys së paku MK dhe ai e ka privuar atë nga jeta duke e qëlluar në kokë që ka rezultuar me vdekjen e tij të menjëhershme. Njëri nga ata katër plumba ka shkuar në thembrën e këmbës së djathtë të DO dhe një tjetër nga ata katër plumba ka shkuar në pjesën e sipërme të të dyja krahëve, të djathtë dhe të majtë, të DB dhe duke vepruar ashtu, i akuzuari e ka rrezikuar jetët e DB dhe DO.

Vlerësimi i provave

Fillimisht, trupi gjykues e ka konsideruar se i akuzuari e ka diskutuar mbrojtjen e tij me avokatët e tij dhe në bazë të këtij konsultimi është deklaruar fajtor në lidhje me akuzën e tij të njëjës vepër të vrasjes së rëndë sipas nenit 147, pika 4 e KPK-së- pika I- dhe vepra penale në vazhdim e mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 paragrafi 2 i KPK-së-pika 2-.

Sipas pikës 1, pranimi i fajësisë së të akuzuarit është mbështetur nga dëshmitë e mëtejme të marra nga trupi gjykues.

Duhet që të përcaktohet përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari ka gjuajtur katër herë me pushkën e tij automatike AK-47 në MK, DB dhe DO dhe se tre nga katër gjuajtjet kanë qëlluar cakun e tyre: Njëri nga plumbat e ka qëlluar MK në kokë dhe e ka vrarë në vend, një plumb tjetër ka shkuar në shputën e djathtë të DO dhe një plumb tjetër i ka qëlluar që të dyja krahët e DB.

Po ashtu nuk ka dyshim se i akuzuari e ka përdorur armën e tij me qëllim që ta privojë nga jeta viktimën MK dhe se i akuzuari ka rrezikuar me katër gjuajtjet e tija po ashtu edhe jetën e DB dhe DO. Edhe pse plagët e B dhe O nuk ishin me rrezik për jetët e tyre, i akuzuari ka rrezikuar jetët e

tyre duke gjuajtur, sepse e shtëna që e ka goditur MK verifikon se sa e rrezikshme është një gjuajte nga një pushke automatike e tipit AK-47.

Është vërtetuar nga raportet e policisë dhe raporti i autopsisë se MK është vrarë nga një e shtëne nga pushka AK-47, e cila është konfiskuar nga makina e të akuzuarit. Të gjitha raportet e përmendura më parë janë lexuar gjatë shqyrtimit kryesor. Sipas raporteve të policisë dhe raporteve mjekësore në lidhje me lëndimet e DB dhe DO, nuk ka dyshime se ato ishin shkaktuar nga të shtënat e po asaj pushke të të akuzuarit.

Trupi gjykues nuk ka mundur që të përcaktojë se DB ka qenë i armatosur me revole dhe se ai ka gjuajtur dy herë pasi që i akuzuari e ka drejtuar pushkën e tij AK-47 në drejtim të tre vizitorëve Serb. Por trupi gjykues nuk ka mundur që ta përjashtojë këtë mundësi dhe andaj e ka konsideruar këtë në favor të të akuzuarit. Arsyeja për këtë pasiguri është si në vijim:

Në njërën anë, dëshmitari DO ka dëshmuar para gjykatës, as ai e as MK e po ashtu DB nuk ishin të armatosur. Dëshmitarja MV ka deklaruar para trupit gjykues gjatë shqyrtimit kryesor se personi që ishte tullac kishte nxjerrë një revole të zezë dhe donte që të ia drejtojë të akuzuarit. Sipas bindjes së trupit gjykues, dëshmitarja e ka përshkruar DB sepse ai ka qenë personi i vetëm që ishte tullac në vendin e ngjarjes. Por, deklarata e MV nuk është bindëse. Para se gjithash, dëshmia e saj është në kundërshtim në krahasim me deklaratën e saj të mëparshme të cilën ajo ia ka dhënë policisë dhe prokurorit publik. Para shqyrtimit kryesor dëshmitarja MV nuk e ka raportuar në polici se njëri nga vizitorët ka qenë i armatosur me pistoletë. Policia e ka intervistuar atë menjëherë pasi që të shtënat kishin ndodhur dhe në këtë kohë, sipas përvojave të zakonshme, memoria e dëshmitarit është e freskët. E konfrontuar me këtë mospërputhje, dëshmitarja ka dhënë sqarimin se ajo nuk ka dashur që të flas me policinë në lidhje me armën në prani të fëmijëve të saj. Por, edhe ky sqarim nuk është bindës sepse djali i saj 11 vjeçar ka arritur në shtëpi nga shkolla pasi që policia kishte ardhur që ta intervistojë dëshmitarin. Dhe, fakti që vajza e saj ka qenë prezente kur ka arritur policia në shtëpinë e saj, nuk mund të shihet si një akt i kujdesit ndaj vajzës së saj që të mos përmendet arma në dorën e njërit nga vizitorët në prani të vajzës së saj, sepse sipas deklaratës së MV, vajza e saj do i kishte dëgjuar të shtënat po ashtu. Kur të shtënat janë dëgjuar, nuk ka kuptim që të mos përmendet arma, të cilën dëshmitarja tani dëshiron që të theksojë se e ka parë në dorën e vizitorit që ishte pa flokë. Përpos faktit se raporti i saj në lidhje me pistoletën, edhe në prani të vajzës së saj, do të kishte qenë i arsyeshëm pa e frikësuar vajzën më tej, do të kishte qenë e lehtë për të që tu tregonte zyrtarëve policor se ajo dëshironte që të ipte sqarime të mëtejme pa praninë e vajzës së saj.

Dëshmitari SS ka dëshmuar të ketë parë se personi që është futur në makinën e kuqe Golf 2, në anën e bashkë-udhëtarit, ka qenë i armatosur me një pistoletë. Është e çartë që ai ka menduar DB i cili- për shkak të plagës në krahët e tij-nuk ka qenë në gjendje që ta hap derën e anës së bashkë-udhëtarit. Por ky përshkrim është plotësisht në kundërshtim me dëshminë e DO i cili ka theksuar se ata kanë qenë të paarmatosur gjatë gjithë kohës.

Trupi gjykues ka marrë në konsideratë se po ashtu edhe dëshmitari GM, në deklaratën e tij para trupit gjykues, ka raportuar në lidhje me një person tullac të armatosur me një revole dhe se ai ka dëgjuar dy gjuajtje armësh. Sidoqoftë, dëshmia e tij nuk është plotësisht bindës dhe është në kundërshtim me deklaratën e palës së dëmtuar DO dhe dëshmitare MV. Derisa dëshmitarja MV e ka përshkruar armën të jetë e zezë, dëshmitari GM ka menduar që ishte e bardhë. Mospërputhja e mëtejme në deklaratën e tij ka qenë se para trupit gjykues ai ka deklaruar që ta ketë parë një person me një pistoletë gjersa gjuante dhe në fazat e mëtejme të procedurës, ai ka deklaruar se nuk e ka parë atë të gjuante, por se vetëm e ka parë armën dhe ti ketë dëgjuar të shtënat.

Ne favor të të akuzuarit, trupi gjykues ka konsideruar se DB ka qenë i armatosur me një pistoletë në ditën kritike dhe e ka përdorur armën e tij duke gjuajtur dy herë pasi që i akuzuari e ka nxjerrë pushkën e tij AK-47 dhe e ka drejtuar tek tre vizitorët.

Gjetjet Ligjore

1) Vrasja e Rëndë

I akuzuari ka kryer veprën penale të *Vrasjes së Rëndë* sipas Nenit 147, pika 4 e KPK-së, sepse ai me qëllim e ka privuar nga jeta viktimën MK duke gjuajtur në kokën e tij dhe ka rrezikuar, me qëllim, me gjuajtjet e tija të mëtejme, jetët e DB dhe DO. Në lidhje me vrasjen e tij ai ka vepruar në mënyrë *dolus directus* sepse ishte vullneti i tij për të vrarë personin mbi mosmarrëveshjen e tokës. Në lidhje me rrezikimin e jetës së D dhe D 's, ai ka vepruar me *dolus eventualis* sepse ai ka marrë në konsideratë faktin se gjuajtet e tija të mëtejme, nga pushka e tij automatike AK-47, mund të shpënin në vdekjen e këtyre dy personave që kanë qenë afër MK dhe ai ka gjuajtur katër të shtëna në drejtim të këtyre tre personave.

Nuk ka pasur mbrojtje të nevojshme, Neni 8 i KPK-së. Trupi gjykues është në tërësi i bindur se ka qenë i akuzuari që e ka përdorur i pari armën e tij të zjarrit. I akuzuari është kthyer në makinën e tij të parkuar në mënyrë që ta merr pushkën e tij AK-47 nga makina, dhe në këtë moment ai ka pasur për qëllim që ta përdori armën e tij duke gjuajtur në MK sepse ai ka kuptuar se ai nuk ishte në gjendje që ta blej pronën. Andaj, ai ka vendosur ta vras M, i cili deri atëherë nuk kishte nxjerrë revolen. Pasi që i akuzuari e kishte marrë armën e tij të mbushur nga makina e tij dhe e kishte drejtuar armën në drejtim të M, D dhe D, i gatshëm që të gjuaj tek ata me qëllim që ta vras së paku M, nuk mund të përjashtohet fakti që M e ka nxjerrë revolen dhe ka gjuajtur dy herë, para se i akuzuari ka filluar serinë e katër të shtënave nga Kallashnikovi i tij, në drejtim të M dhe dy shoqëruesve të tij.

Sipas bindjes së trupit gjykues, M në asnjë mënyrë nuk e ka nxjerrë revolen e tij në një fazë të mëhershme, dhe posaçërisht, jo para se i akuzuari e ka nxjerrë Kallashnikovin e tij, sepse kjo nuk do kishte asnjë kuptim. M ka qenë i gatshëm që ta shes pronën e tij. Nuk do kishte kuptim fare që ta vriste blerësin e mundshëm potencial të tokës. Dhe nëse ai do kishte një qëllim aq të

pakuptimtë, ai ka mundur dhe do ta kishte vrarë të akuzuarin më parë sa ka qenë afër tij dhe jo më vonë kur i akuzuari ka shkuar te makina e tij.

Meqë trupi gjykues është i bindur se ka qenë i akuzuari që e ka nxjerrë armën e tij së pari, ka qenë M ai që ka vepruar në mbrojtje të nevojshme kur ai e ka nxjerrë revolen e tij dhe edhe pse duhet që të merret si një fakt që M ka gjuajtur dy herë i pari para se i akuzuari ka filluar që të gjuante, por ka qenë M që ka vepruar në mbrojtje të nevojshme, Neni 8 i KPK-së. Dhe nuk ka mbrojtje të nevojshme të mundur kundër një veprimi i cili arsyetohet nga mbrojtja e nevojshme. Me fjalë tjera: M ka vepruar në mbrojtje të nevojshme dhe gjuajtjet e të akuzuarit nuk janë arsyetuar me mbrojtje të nevojshme.

2) *Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve*

I akuzuari ka qenë në posedim të një *corpus delicti* të pa regjistruar, pushka AK-47, një armë automatike dhe ai e ka përdorur atë në ditën kritike duke gjuajtur katër herë. Andaj, ai e ka kryer veprën penale sipas Nenit 328, paragrafi 2 i KPK-së.

Përcaktimi i dënimit

I. Vrasja e Rëndë

Neni 147 i KPK-së parasheh një kornizë të dënimit prej të paktën dhjetë vjet burgim ose me burgim afatgjatë.

Brenda kësaj kornize, trupi gjykues ka vlerësuar të gjitha aspektet relevante në favor dhe në disfavor të të akuzuarit.

a) Faktorët lehtësues

Si faktor kryesor lehtësues trupi gjykues ka marrë faktin se i akuzuari- pas konsultimit me avokatët e tij mbrojtës- ka pranuar që e ka kryer vrasjen dhe ai ka shprehur keqardhje për viktimën.

Për më tepër, trupi gjykues ka ndjekur mendimin e ekspertit mjekësor dhe ka ardhur në përfundim se “ *IN TEMPORE CRIMINIS aftësia e të akuzuarit për ta kuptuar rëndësinë e veprimeve të tija dhe mundësinë që ti kontrollojë veprimet e tija, është zvogëluar por jo dhe në thelb*”. Andaj, kjo rrethanë po ashtu është marrë si një faktor lehtësues e cila ka rezultuar për një dënim më të ulët kundrejt të pandehurit.

Faktor tjetër lehtësues, trupi gjykues ka konsideruar sjelljen e viktimës, para se i pandehuri ta përdori Kallashnikovin e tij. Në veçanti, trupi gjykues ka konsideruar se i akuzuari do të jetë ndjerë i provokuar nga tre persona Serbë dhe nuk mund të përjashtohet fakti se ata e kanë ofenduar MV, një anëtare e familjes së të akuzuarit, dhe po ashtu nxjerrja e revoles dhe dy gjuajtjet nga ajo revole pasiqë i akuzuari e ka drejtuar Kallashnikovin e tij në drejtim të tre personave Serb.

Si faktor lehtësues më tej, duhet që të konsiderohet edhe shkallëzimi i mosmarrëveshjes në lidhje me pronën apo tokën fqinje dhe emocionet e të akuzuarit të tendosura nga kjo fjalosje.

Mosha e avancuar e të akuzuarit është një aspekt më tej të cilin trupi gjykues e ka marrë në konsideratë e në favor të të pandehurit.

b) Faktorët Rëndues

Si një faktor rëndues trupi gjykues ka konsideruar veprimet e të akuzuarit e të cilat kanë rrezikuar jetën e dy personave tjerë kur ai ka gjuajtur me Kallashnikovin e tij. Ky veprim, jo vetëm që ka rrezikuar jetën e dy personave, por edhe i ka lënduar dy nga ata duke u shkaktuar plagë të rënda.

Duke i konsideruar të gjithë këta faktorë, trupi gjykues ka shqiptuar dënimin prej 15 vjetësh dhe gjashtë muajsh burgim.

2. Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve

Neni 328, par 2 i KPK-së parasheh një dënim me gjobë deri në shumë prej 7.500€ apo burgim prej një e deri në tetë vite.

Brenda kësaj kornize, trupi gjykues konsideron të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues.

Si faktor lehtësues trupi gjykues konsideron pranimin e fajit të të akuzuarit dhe pendimin e tij.

Si një faktor rëndues, trupi gjykues konsideron se arma ka qenë një pushkë automatike dhe në veçanti një armë e rrezikshme.

Duke i konsideruar të gjithë këta faktorë, trupi gjykues ka shqiptuar dënimin prej një viti burgim.

Duke pasur parasysh që të dyja dënimet, trupi gjykues shqipton dënimin prej 16 vitesh burgim si një dënim i përgjithshëm kundër të akuzuarit.

Shpenzimet e procedurës penale

Sipas Nenit 99 par 2, pika 6 e KPPK-së, i akuzuari NV do ti paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 400 (katërqind) Eurosh, duke llogaritur nga 100 (njëqind) Euro për secilën seancë dhe shumën e caktuar prej 100 (një qind) Eurosh.

GJYKATA E QARKUT NË PEJË
P.nr.68/12
E datës 04 Korrik 2012

Anëtar i trupit gjykues

Anëtar i trupit gjykues

Anëtar i trupit gjykues

Procesmbajtëse

Eriona Brading

Këshillë Ligjore:

Personat e autorizuar mund të parashetrojnë ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi dhe atë përmes Gjykatës së Qarkut në Pejë për Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur kopja e aktgjykimit u është shërbyer palëve, sipas Nenit 398, Par 1 i KPPK-së.